

LIGJ
Nr.7689, datë 17.3.1993

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7574, DATË 24.6.1992 "PËR ORGANIZIMIN E DREJTËSISË DHE DISA NDRYSHIME NË KODET E PROCEDURAVE PENALE E CIVILE"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7574, date 24.6.1992, në nenin 2, paragrafi i dytë ndryshohet si vijon:

"Gjykatat e apelit shqyrtojnë ankimet dhe protestat kundër vendimeve penale e civile të gjykatave të shkallës së parë. Ato gjykojnë me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë".

Neni 2

Neni 10 ndryshohet si vijon:

"Ministri i Drejtësisë, në raste të veçanta ose me kërkesë të arsyetuar mund të ngarkojë një gjyqtar të gjykatës së rrethit, të gjykatës ushtarake ose të gjykatës së apelit për të gjykuar përkatësisht në një gjykatë tjetër rrethi, ushtarake apo apeli."

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas shpalljes në Fletoren Zyrtare."

Shpallur me dekretin nr.502, datë 26.3.1993 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha